



KOMISIONI I PAVARUR PER MINIERA DHE MINERALE (KPM), Në bazë të nenit 59.1 dhe nenit 62, të Ligjit për Miniera dhe Minerale Nr. 03/L-163, dhe nenit 103 të Ligjit Nr.02/L-28 për Procedurën Administrative, Bordi i Komisionit të Pavarur për Minierat dhe Mineralelet në mbledhjen e mbajtur me datë 11.12.2015 nxjerre këtë:

REPUBLIC OF KOSOVO KOMISIONI I PAVARUR PER MINIERA DHE MINERALE INDEPENDENT COMMISSION FOR MINES AND MINERALS	
DEKRETI DEKRETI DEKRETI	NR. PROT. BR. PROT. NR. PROT. 5051
NUM. FAJES BROJ STRANA NR. D. DATES	DL MM VVVV DL MM GGGO MM VVVV 16/12/2015
PRISHTINE	

VENDIM

- 1- Shfuqizohet vendimi i Bordit nga mbledhja e datës 29.10.2015 pika 4.1 në lidhje me shqyrtimin e ligjit Nr.05/L-043 si dhe udhëzimit administrativ (QRK) - Nr.04/2015 për procedurën e faljes së borxheve publike, nga procesverbali i mbledhjes së Bordit me nr.protokolli 8658 dt.03.11.2015.
- 2- Shfuqizoht vendimi i Bordit nga mbledhja e datës 23.11.2015 pika 5.3, në lidhje me zbatimin e ligjit për faljen e borxheve publike nga procesverbali i mbledhjes së Bordit me nr.protokolli 9272 dt.26.11.2015.
- 3- Shfuqizohet vendimi nga Drejtori i KPM-së, me nr.protokolli 4414 i datës 13.11.2015 në lidhje me formimin e komisionit për shqyrtimin e ankesave sipas udhëzimit administrativ (QRK) Nr.04/2015 për Procedurat e Faljes së Borxheve Publike.
- 4- Obligohet ekzekutivi i KPM-së, në zbatimin e këtij vendimi të marrë nga Bordi i KPM-së, pas shfuqizimit të këtyre vendimeve si dhe heqjes së listës së kompanive që kanë obligime ndaj KPM-së, nga web-faqja e KPM-së.

ARSYETIM

Bordi i KPM-së, duke u bazuar në shkresën nga Ministria e Financave (MF) ku sqarohet se dispozitat e Ligjit Nr.05/L-043 për Faljen e Borxheve Publike dhe dispozitat e Ligji Nr. 03/L-163, Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale nuk është institucion i zbatimit të Ligjit për Faljen e Borxheve dhe se dispozitat e Ligjit për Faljen e Borxheve nuk vlejnjë për obligimet që kanë operatorët ndaj institucionit tuaj, pas shqyrtimit të kësaj shkrese Bordi i KPM-së, në mbledhjen e mbajtur me datën 11.12.2015 u pajtua që ti rishqyrtoj vendimet e marra nga mbledhja e Bordit e datës 29.10.2015 pika 4.1 në lidhje me shqyrtimin e Ligjit Nr.05/L-043 si dhe Udhëzimit Administrativ (QRK) - Nr.04/2015 për Procedurën e Faljes së Borxheve Publike, nga procesverbali i mbledhjes së Bordit me nr.protokolli 8658 dt.03.11.2015 dhe vendimit nga mbledhja e datës 23.11.2015 pika 5.3, në lidhje me zbatimin e ligjit për faljen e borxheve publike nga procesverbali i mbledhjes së Bordit me nr.protokolli 9272 dt.26.11.2015.

Pas rishqyrtimit të këtyre vendimeve Bordi i KPMM-së, duke pasur parasysh shkresën nga Ministria e Financave u pajtuan dhe vendosën si në dispozitiv të këtij vendimi.

Obligohet ekzekutivi i KPMM-së, në zbatimin e këtij vendimi.

Vendimi i dorëzohet:

1. Ekzekutivit të KPMM-së,
2. Arkivit të KPMM.


Midin Bojaxhiu
Drejtor
Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale

